



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

01-1672

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-03 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 17, pika “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, si dhe duke vendosur sipas kërkesës me nr. **05-350/02-207227/23 dt. 17.10.2023** të pronares Mirsade Mulolli, rr.Xhavit Ahmeti p.n, Prishtinë për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e shtëpisë për banim individual, në bllokun urban “G-04” të tërësisë urbane "G", të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 09.09.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore pronares Mirsade Mulolli sipas kërkesës me nr. 05-350/02-207227/23 dt. 17.10.2023, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë për banim individual me etazhitet B+P+1, të bllokut “G-04” të tërësisë urbane "G", të Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia" në Prishtinë, në parcelen kadastrale nr. 1087-2, Z.K Prishtinë.

II. Lokacioni për të cilin caktohen kushtet ndërtimore gjendet në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”, i miratuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr.031-247790 të dt. 04.10.2016, ku sipas këtij plani, kjo zonë është e planifikuar për “banim individual”, Lidhur me këtë dhe me parametrat e ndërtimit nga ky plan, pronari është informuar me “Informim nga Plani Rregullues i Hollësishëm –Sofalia 2016-2024” me nr.04-350/01-166655/23 dt. 23.08.2023 nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm – Prishtinë.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
 - nr. 01087-2, me S= 594 m², me pronare Mirsade Mulolli,
 - 500 m² - oborr, tokë ndërtimore
 - 56 m² - shtëpi, tokë ndërtimore dhe
 - 38 m² – arë e kl. 4
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Në kuadër të parcelës me nr.1087-2, Z.K Prishtinë gjendet ndërtesa-shtëpia me etazhitet B+P.
- Terreni ka një ramje të lehtë në raport me rrugën;
- Parcela kadastrale ka qasje në rrugën ekzistuese dhe rrugën e planifikuar sipas këtij Plani Rregullues të Hollësishëm;
- Në diametër prej 50 m' ka shtëpi të ndërtuara, kryesisht me destinim "banimi".
- Sipas Planit Rregullues të hollësishëm “Sofalia”, 159 m² të parcelës kadastrale 1087-2, kalojnë në rrugën e planifikuar.

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin – ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Vija ndërtimore ndaj vijës rregulluese, pozicionimi dhe gabariti i ndërtesës, dhe kushtet tjera për rregullimin e parcelës ndërtimore të jenë në tërësi sipas Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”, dhe sipas prezantimit grafik të prezantuar në dokumentacionin ndërtimor.
- Parcela minimale për ndërtim sipas Planit Rregullues të Hollësishëm „Sofalia” është 400m² me përjashtim të parcelave më të vogla, ndarjet e të cilave kanë ekzistuar para fillimit të hartimit të Planit Rregullues.
- Parcela ndërtimore e trajtuar me këto kushte ndërtimore, prej vijës rregulluese ka sipërfaqen 435m², ndërsa sipërfaqja prej 159 m² do të mbetet sipërfaqe me interes publik dhe do të shpronësohet në fazën e realizimit të rrugës, të planifikuar sipas Planit Rregullues. ISHP dhe ISPN për projektin ideor duhet të kalkulohen sipas sipërfaqes së parcelës ndërtimore prej 435m².
- Etazhiteti i ndërtesës, sipas planit rregullues është P+2,
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, sipas Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”, është banim individual i ulët,
- Indeksi i shfrytëzimit të parcelës (ISHP), është max.0.30 e sipërfaqes së parcelës. Në rastin konkret 30% e parcelës ndërtimore, brenda vijës rregulluese, me sipërfaqe 435 m², në bazë të “Situacionit të parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese në sistemin koordinativ KOSOVAREF01.

$$S=435 \times 30\% = 130.50 \text{ m}^2 / \text{lejuar sipas PRR};$$
$$S= 129.50 \text{ m}^2 / \text{sipas projekt propozimit} /.$$

- Indeksi i sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore (ISPN), është max.0.8;
 $S=435 \times 0.8 = 348.00 \text{ m}^2 / \text{lejuar sipas PRR};$
 $S= 250.28 \text{ m}^2 / \text{sipas projekt propozimit} /.$
- Indeksi i shfrytëzimit të nëntokës (ISHN), max. 0.5;
 $S=435 \times 0.5 = 217.50 \text{ m}^2 / \text{lejuar sipas PRR};$
 $S= 105.27 \text{ m}^2 / \text{sipas projekt propozimit} /.$
- Indeksi i sipërfaqes së gjelbrimit është (ISGJ), min. 0.5;
 $S=435 \times 0.5 = 217.50 \text{ m}^2 / \text{lejuar sipas PRR};$
 $S= 274.50 \text{ m}^2 / \text{sipas projekt propozimit} /.$
- Sipas projekt propozimit sipërfaqja e përgjithshme ndërtuese është 355.55 m² / 250.28m² mbi tokë dhe 105.27 m² nën tokë.(sipërfaqja ndërtuese e propozuar është brenda kufirit të lejuar)
- Qasja në parcelë duhet të jetë nga rruga ekzistuese njëkohësisht edhe rrugë e planifikuar.
- Distanca e vendosjes së ndërtesave ndaj kufirit të parcelës, për kthina primare min 0.5 H, për kthina sekundare min.0.2 H, dhe marrveshja me fqinun deri në bashkim të plotë;
- Nëse në fasadat e ndërtesës me orientim nga fqinjët kanë hapje sekondare si shkallë, depo, banjo e të tilla kthina të ngjashme, të cilat nuk kanë nevojë për diellzim, por vetëm për ndriçim dhe ajrosje, distanca minimale është 0.2h nga kufiri i parcelës.
- Nëse në fasadat e ndërtesës me orientim nga fqinjët nuk ka hapje ndriçim distanca minimale është 0.2h nga kufiri i parcelës. Por me pëlqim paraprak të fqinjëve, kjo distancë mund të zvogëlohet deri në bashkimin e plotë.
- Kuota e përdhësës së ndërtesës përcaktohet në raport me kuotën e niveletës së rrugës publike nga e cila ka çasje parcela, gjegjësisht në krahasim me kuotën zero;
- Kuota e përdhësës së ndërtesave të reja nuk mund të jetë më e ulët se kuota e niveletës së rrugës publike;
- Kuota e përdhësës mund të jetë më së shumti 1,4 m mbi kuotën e rrugës nga e cila ka çasje.

- Ndërtesat që në përdhese kanë tregti apo shërbime kuota e përdhese mund të jetë më lartë se kuota e trotuarit për max 0.3m.
- Distanca në mes vijës ndërtimore dhe asaj rregulluese është 5.0 m.
- Nëse parcela ka pjerrtësi terreni i tillë që mbulon më shumë sesa një kat në njërin drejtim, atëherë sipërfaqja ndërtimore llogaritet 50%,
- Me kërkesë të posaçme dhe duke marrë pëlqimin e qytetarëve në rreze prej 50m, mund të lejohet edhe ndërtimi i shërbimeve të tjera jo shqetësuese, me qëllime afariste, ndërmarrje tregtare, zejtare, fetare, kulturore, sportive etj duke përfshirë edhe hapësirat shërbyese.
- Për të siguruar pamje të përshtatshme dhe të organizuar të kulmeve në zonë, këndi i kulmeve të pjerrëta është kufizuar në maksimum 45°;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që uji i strehëve duhet të pikojë brenda parcelës kadastrale;
- Pamja e rrugës përcaktohet nga ndërtesat e ndërtuara, por në mënyrë vendimtare edhe nga lartësia e mureve fqinje, gardheve, dhe rrethimeve tjera. Për ta parandaluar ndërhyrjen pamore të hapësirës së rrugës, lartësia është kufizuar në 1,5 m.
- Te shtëpitë për banim individual parashihet 1 vendparkim/njësi banimi.
- Gjatë ndërtimit të ndërtesës, ndërtesat fqinje të sigurohen me masat mbrojtëse adekuate.
- Arkitektura e ndërtesës së re t'i përshtatet ambientit që e rrethon dhe vlerave ambientale;
- Para aplikimit për Leje ndërtimore duhet të aplikoni për Leje të rrënitimit për shtëpinë ekzistuese, brenda kësaj parcele.

V. Ndarja/ parcelimi i parcelës kadastrale nr.1087-2 Z.K Prishtinë, do të realizohet sipas zgjidhjes urbane, të miratuar me këto kushte ndërtimore, përcaktuar me manualin e ndarjes punuar nga gjeodeti i licencuar. Kjo drejtori përmes këtij paragrafi të vendimit të kushteve ndërtimore jep PËLQIM për ndarjen e parcelës kadastrale të lartëcekur, sipas zgjidhjes urbane. Procedura e ndarjes /parcelimit, do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve. Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarit duke u bazuar në Planin e situacionit - "Zgjidhjen Urbane".

- Pas ndarjes së parcelës, sipas manualit të gjeodetit, sipërfaqja e evidentuar si tokë ndërtimore në regjistrin kadastral do të rezervohet për parcelën ndërtimore, brenda vijës rregulluese me S=435m². Ndërsa sipërfaqja prej 121 m² e evidentuar si tokë ndërtimore dhe 38 m² të evidentuara si tokë bujqësore - arë e kl. IV-të, me sipërfaqe të përgjithshme prej S=159 m² do të rezervohen për rrugën e planifikuar.

VI. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VII. Dokumentacioni ndërtimor - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m, me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë,

si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;

- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhese, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme.

VIII. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit.

IX. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullores mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 Nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017 dhe Rregulloren për Plotësim dhe Ndryshimin e Rregullores mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës “01- 434/01-0094474/17 dt.01.12.2023 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

X. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Aplikuesja Mirsade Mulolli nga Prishtina, me kërkesën nr. 05-350/02-207227/23 dt. 17.10.2023, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e shtëpisë, për banim individual me etazhitet B+P+1 në lokacionin e përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtyre Kushteve ndërtimore.

Bashkangjitur me kërkesë aplikuesi ka prezantuar: provën mbi të drejtën pronëso-ro-juridike në lokacionin në fjalë, për parcelen kadastrale nr. 01087-2 ZK Prishtinë, të evidentuar në çertifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-01087-2 Z.K Prishtinë të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës, kopja e pasaportës e Mirsade Mulollit, “Informim nga Plani Rregullues i Hollësishëm –Sofalia 2016-2024” me nr.04-350/01 - 166655/23 dt. 23.08.2023 nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm – Prishtinë, Autorizimi LRP-Nr.Rend. 13288/2023 dt.11.08.2023 për përfaqësim i Mirsade Mulollit për Ismail Mulollin, kopja e letërnjoftimit e Ismail Mulollit, inçizimin gjeodezik për parcelën kadastrale nr. 1078-2 të punuar nga gjeodeti i licencuar Afrim Bytyqi, me nr.të licencës 1, Projekti konceptual i punuar nga „ARCUS-S”SH.P.K me numër të biznesit 810143909.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 05-350/02-207227/23 dt. 17.10.2023, kritereve të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”, si dhe nenin 13, pika 1.2 të UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt.23.05.2017, ka vendosur njoftimin publik me datë 26.02.2024. Ky njoftim publik,

sipas rregullativës ligjore, ka qëndruar pesë 5 ditë në lokacionin në fjalë dhe meqë ndërkohë kjo drejtori nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo sygjerim, është vazhduar me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje të parcelës në rrugën ekzistuese, njëkohësisht edhe rrugën e planifikuar dhe është konstatuar, si në vijim:

Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Mirsade Mulolli, në Sofali, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-207227/23 dt.17.10.2023, kyçja për automjete në rrugën ekzistuese “Xhavit Ahmeti”, e cila rrugë është e paraparë edhe me planin rregullues “Sofalia”, për ndërtesën banimore shtëpi me etazhitet B+P+1, të paraparë me këtë zgjidhje urbane, mund të pranohet si e till, marrë parasysh edhe gjendjen faktike të rrugës së planifikuar ne raport me parcelën 01087-2, Zk. Prishtinë. Kyçja duhet ti përshtatet teknikisht rrugës së planifikuar, dhe të zbatohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes, dhe në kohën kur rruga realizohet sipas planit.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, ka konstatuar se propozimi për kushte ndërtimore është konform kritereve të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”, i miratuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr.031-247790 të dt. 04.10.2016, nenit 17 të Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012 si dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 10/2013 për përcaktimin e procedurave për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte dhe leje ndërtimore.

Ky organ, pas shqyrtimit të kërkesës dhe provave tjera të bashkangjitura, konsultimit të planeve urbanistike për hapësirën ku gjendet lokacioni si dhe të rregullativës ligjore nga lëmi i ndërtimit dhe asaj nga lëmi i procedurës së përgjithshme administrative, konstatoi se, janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për lëshimin e këtyre Kushteve Ndërtimore.

Shtojcë: Shtojcë: Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues në Sistemin Koordinativ KosovaRef01, Plani i situacionit -"zgjidhja urbane" dhe manuali për ndarje të parcelës nga gjeodeti i licencuar.


Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

Ky vendim u printua në 4 (pesë) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesit/Investitorit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës.


Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik.


**DREJTORIA E URBANIZMIT, E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
NR. . 05-350/02-207227/23 DT. 09.09.2024**

Zyrtari,
Mejrushe Sejdullahu



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi







Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: PRISHTINË

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 1087-2

Zona kadastrale / Katastarska zona: PRISHTINË

Numri i lëndës / Broj predmeta: 109 / 2024

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice PARCELË


Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 000



PROPOZIM NDARJA E PARCELËS 1087-2

LISTA E KOORDINATAVE :

Nr	Y	X
1	7515209.94	4725680.90
2	7515211.41	4725683.91
3	7515212.11	4725685.35
4	7515212.89	4725687.48
5	7515213.38	4725687.24
6	7515213.79	4725688.14
7	7515214.46	4725689.38
8	7515215.32	4725690.50
9	7515216.35	4725691.46
10	7515217.52	4725692.25
11	7515218.80	4725692.84
12	7515220.15	4725693.23
13	7515221.55	4725693.39
14	7515222.96	4725693.33
15	7515224.34	4725693.05
16	7515225.79	4725692.49
17	7515235.01	4725688.14
18	7515235.98	4725687.58
19	7515236.84	4725686.87
20	7515237.58	4725686.03
21	7515238.17	4725685.07
22	7515238.60	4725684.04
23	7515238.85	4725682.95
24	7515238.93	4725681.83
25	7515238.82	4725680.72
26	7515238.52	4725679.63
27	7515235.26	4725670.56
28	7515234.60	4725668.92



Rilevoi / Snimio: AFRIM BYTYÇI
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prozimo geodeta/ kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 1

Nënshkrimi / Potpis:

Data e rlevimit / Datum snimanja: 13.08.2024.



Aprovoi / Usvojio: _____
(emri dhe mbiemri i përsosnit zyrtar/ ime i prezimo sluzbenog lica)

Nënshkrimi / Potpis: _____

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREF01





Punoi:
Kushtrim Domaneku

Nëshkrimi : _____

Prishtinë: 24.05.2024

Legjenda:

- Vija Rregulluese sipas PRRU
- - - - - Vija Ndërtimore për banim
- Parcela Kadastrale



- VIJA E PARCELËS- S-597.96M² (Gjendja ekzistuese)
- MURI RRETHUES I PARCELËS,S-529.56M² (Gjendja ekzistuese)
- VIJA RREGULLUESE E PARCELËS SIPAS PRRU,S-435.00M²
- VIJA NDËRTIMORE SIPAS PRRU(S METRA E LARGUAR NGA RRUGA)
- VIJA E GABARITIT TË OBJEKTIT
- 1087-2 NUMRI I PARCELËS KADASTRALE
- KUFIRI I PARCELAVE SIPAS KADASTRIT
- MURET E INQIZUARA (me kuotë absolute)
- RRUGA E ASFALTUAR (me kuotë absolute)
- EMRI I RRUGËVE
- SHTËPI E INQIZUAR (me kuotë absolute)
- IZOHIPSA ME EKUIDISTANCË e=0.1m
- PUSTEA KANALIZIMIT
- SHTYLLA ELEKTRIKE E DRURIT (me kuotë absolute)
- PIKË GJEODEZIKE-REFERUESE E RENDIT t-të
- TROTUARI

STUDIO PROJEKTORE: "ARCUS-S" SH.P.K <small>Arbnore Jaha, Rr. "Xhavit Ahmeti" Nr. 1087-2 Të. +383 (0)49 220 543 +383 69 435 000</small>	INVESTITOR: Mirsade Mulolli	
	Adresa e ndërtimit: Sofali, Prishtinë	
	Shtet: Kosove	Komuna: Prishtinë
	Nr i parcelës: 01087-2	Kodi postar: 10000
Projekti kryesor: Shtëpi banimi	Objekti/Etazhët: E=B+P+1	
Projektori: I.d.a.Arbnore Jaha	Emeritimi: SITUACIONI	Përjësia: 1:150
Faza investitoriale: ARKITEKTURA	Kontrollues: I.d.a.Arbnore Jaha	Fleta: A-04
Maj 2024	Vërejtje: Ky projekt është pronë e kompanisë dhe si i tillë kopjimi dhe redaktimi nuk lejohet pa miratimin e kompanisë.	Orientimi:

190352
671.951